



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 19.9.2023

Nr: 781

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**KRIJIMIN E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT TË POSAÇME NR. 0636/01, KZAZ NR. 11, BASHKIA KUKËS, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenit 62, pika 2 dhe nenit 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, Bashkia Kukës me shkresën nr. 6910 prot., datë 19.9.2023, “Kërkesë për krijimin e KQV-së së posaçme”, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 0636/01, të IEVP Kukës, me 16 votues.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimit dhe të marrë masat për të siguruar infrastrukturën e nevojshme, sikundër të gjitha qendrat e tjera të votimit.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

Data 19.9.2023 Nr: 781  
Ora: 11:30



“Për krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të posaçme nr. 0636/01, KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”

## V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 11, Bashkia Kukës, që me vendim të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 0636/01, IEVP Kukës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër orëve) nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

